



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1094 / Prot.
13

Tiranë, më 22 / 12 / 2020

V E N D I M

Nr.23, datë 22.12.2020

“PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT
“DOKTORATË” PRANË DEPARTAMENTIT TË BURIMEVE TË ENERGJISË, NË FAKULTETIN E
GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE, NË FUSHËN: INXHINIERI NAFTE DHE GAZI”.**

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr.41, datë 24.1.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", VKM Nr.879, datë 18.12.2019 për "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.1.2018", Udhëzimit të MASR Nr. 1, datë 14.01.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizmin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë," kërkesën e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave dhe Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.12.2020,

V E N D O S I:

Miratimin e propozimit për hapjen e programit të ciklit të tretë të studimit "Doktoratë" pranë Departamentit të Burimeve të Energjisë, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave në fushën: Inxhinieri Nafte dhe Gazi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea MALLQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al

